



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 4140/ 2 prot.

Tiranë, më 22.07.2026

Lënda: Kthim përgjigje.

Gazeta “Koha Jonë”
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Pallatet e Aviacionit nr.2
Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj të protokolluar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore me nr. 4140/1 prot, datë 16.07.2026, me objekt “Kërkesë për informim”, lidhur me ankesën e z. Sh. T. për mosnjohjen nga DRSSH Tiranë të një periudhe punësimi, ju bëjmë me dije se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron të dhëna që hyjnë në grupin e të dhënave personale, përpunimi i të cilave, rregullohet nga Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në pikën 3, të nenit 5 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se *“E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash”*.

Sipas pikës 2 të nenit 6 të Ligjit nr. 124/2024, Përpunimi i të dhënave personale bëhet duke respektuar parimet si më poshtë :

2.Parimi i përpunimit në përputhje me qëllimin, që nënkupton se të dhënat personale mbledhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, të përcaktuar qartë në momentin e mbledhjes, dhe nuk përpunohen më tej për një qëllim tjetër, që nuk është në përputhje me qëllimin fillestar.

Referuar dispozitës së sipërcituar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron të dhëna personale dhe i përpunon ato vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara nga ligjet e zbatueshme në fushën e sigurimeve shoqërore, të cilat kanë në thelb caktimin e përfitimeve nga ISSH.

Në nenin 7 të ligji, janë parashikuar kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, ku në pikën 1/a, përcaktohet se përpunimi i të dhënave lejohet kur ***“subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale për një apo më shumë qëllime specifike”***.

Dispozita ligjore e sipërcituar parashikon se të dhënat personale përpunohen vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave dhe për qëllimin për të cilin ky pëlqim është dhënë, si dhe parashikon kushtet që duhet të respektohen në fushën e përpunimit të këtyre të dhënave.

Në kërkesën tuaj drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nuk rezulton i administruar asnjë autorizim i subjektit lidhur me të dhënat e kërkuara nga ana juaj.

Sa më sipër, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nuk mund t'ju vërë në dispozicion informacionin e kërkuar për subjekte të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin me dokument përfaqësimi apo nuk janë vetë kërkuar të dhënave të caktuara.

Faleminderit për bashkëpunimin !